



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 78, Datë 12.03.2026

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K. PËR
KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË
ORIGINJËS**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 826/1 prot., datë 09.03.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë NOA ENERGY TRADE sh.p.k për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k.

- Shoqëria “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 07, datë 02.02.2015, i ndryshuar dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 02.12.2021.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k, me shkresën nr. 826 prot., datë 05.03.2026, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në përputhje me nenin 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024.
- Shoqëria ka depozituar formularin e aplikimit të plotësuar sipas kërkesave të nenit 6, pika 4.1 të rregullores, duke specifikuar të dhënat identifikuese.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI